



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 739 Prot
Nr. 2241 Dosje

Tiranë, më 09.06.2022

URDHËR

(PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbardimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k, në referim të Vendimit Nr.23-2021-1190(507), të lëshuar me datë 26.07.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kam vene ne ekzekutim kete vendim gjyqësor, duke regjistruar ne dosjen permbarimore Nr.2241, date 13.12.2021, kerkesen e kreditorëve Arjan Piro, Shani Piro, Ylli Piro, Vladimir Piro, Rozina Piro, Livia Piro, Ridgers Piro, ndaj debitorit Shoqëria “BISTRICA 3 ENERGY” Sh.p.k.

Për sa më sipër, duke kryer veprimet e nevojshme procedurale për ekzekutimin e Vendimit Nr.23-2021-1190(507), të lëshuar me datë 26.07.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë,

KONSTATOVA

Se me datë 09.06.2022 vihemi në dijeni nga ana e Shoqërisë “BISTRICA 3 ENERGY” Sh.p.k se me anë të Vendimit Nr.23-2022-735, të lëshuar me datë 05.05.2022 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është vendosur rivendoja në afat të Shoqërisë “BISTRICA 3 ENERGY” Sh.p.k. për ushtrimin e të drejtës së ankimit në Gjykatën e Apelit, kundër vendimit civil Nr.23-2021-1190(507), datë 26.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, vendim i cili nga shënimi i kryesekretarisë ka marrë formë të prerë në datën 07.06.2022, pasi nuk u ankimua nga palët.


Lidhur sa më sipër, ne referim te neneve 527 dhe 528 te Kodit te Procedures Civile,

URDHËROJ

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga Shoqëria “BISTRICA 3 ENERGY” Sh.p.k, me NIPT K82118005R, bllokuar me shkresën Nr.1422 Prot., datë 29.12.2021 të Zyrës së Përmbardimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k.
2. Per veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor.



Zyra e Përmbardimit Privat “TDR Group” sh.p.k
Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta” Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë
Tel : 00355 42 427790
www.tdr.al



3. Personat që behen pengese, do te pergjigjen ne baze te nenit 606 te K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallzimin penal.
4. Kjo kerkese perpilohet dhe mbahet ne disa kopje.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR-GROUP" sh.p.k.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

FLORIAN SHEHU

